

Albanska

Ligji suedez obligon të gjithë që posedojnë aparat televiziv t'i paguajnë taksë Radiotjänsten (Shërbimet radio-televizive). Falë kësaj pagese Televizioni dhe Radioja Suedeze, si dhe Programi arsimor, kanë mundësi të shfaqin programe të pavarura nga kompanitë afariste dhe politika aktuale. Kjo ndryshe quhet public service, d. m. th. radio dhe televizion në shërbim të interesit të përbashkët shoqëror, dhe ofron emitime lajmesh, programe dokumentare dhe program argëtues dhe arsimor.

Aparat televiziv konsiderohet çdo mjet me të cilin është paraparë të pranohen emitimet televizive, çfarëdo që të jetë mënyra e pranimi të këtyre valëve. Shembull ilustrues i asaj që konsiderohet aparat televiziv mund të merret vetë televizori, video, kompjuter me kartelë televizive, pranues digjital televiziv dhe DVD rekorder. Nëse banoni me qira në një banesë që ka aparat televiziv atëherë ju jeni të obliguar që të paguani taksën televizive. Taksa televizive nuk përfshihet në taksën e televizionit kabllorik, satelitor apo digjital. Nuk ka poashtu fare rëndësi nëse keni huazuar apo posedoni aparat televiziv dhe cilat kanale ju keni mundësi të shihni. Të gjithë që kanë aparat televiziv duhet t'i paguajnë taksën public service.

Nëse posedoni aparat televiziv atëherë ju mund ta lajmroni atë në www.radiotjanst.se. Mirëpo ju poashtu mund të telefononi në numrin 0771-91 00 04 ose të dërgoni letër në adresën Radiotjänst i Kiruna AB, 981 80 Kiruna.

Falemnderit që paguani taksën televizive.

Website in English: www.radiotjanst.se/en